



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

Nr. 84 prot.

Kamëz, më 26. 9. 2025

V E N D I M
Nr. 72 .Datë 26 / 9 2025
MBI

“DISA SHTESA NË VENDIMIN E KËSHILLIT BASHKIAK KAMËZ NR. 120, DATË 19.12.2024, PËR: “MIRATIMIN E TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE NË BASHKINË KAMËZ”, TË NDRYSHUAR”.

Këshilli Bashkiak Kamëz i mbledhur sot me datë 26.09.2025, pasi mori në shqyrtim Projekt-vendimin Nr.66 Datë 18.09.2025 në mbështetje të Ligjit nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative” i Republikës së Shqipërisë, Ligjit nr. 139. datë 17.12.2015, “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar, Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin E Taksave Vendore”, i ndryshuar, Ligjit nr.68/2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore”; **Këshilli Bashkiak Kamëz**;

V E N D O S I:

1. Miratimin e disa shtesave në vendimin e Këshillit Bashkiak Kamëz nr. 120, datë 19.12.2024 për, “Miratimin e Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Kamëz”, të ndryshuar.
2. Në tabelën e kategorisë C.8 “Tarifa për shërbimin në fushën e transportit të pasagjerëve dhe mallrave, dhënia e lejeve për ushtrim aktiviteti”, të Vendimit nr.120, datë 19.12.2024, të Këshillit Bashkiak Kamëz, “Për sistemin e Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Kamëz”, të ndryshuar, pas pikës 6 të pikës I “Transport udhëtarësh”, bëhet shtesa si më poshtë:

Nr	Emërtimi	Njësia	Tarifa
7.	Libër udhëtimi për shërbimet e rastit Brenda vendit.	Për libër	5,000

3. Në tabelën e kategorisë C.9 “Tarifa parkimit për automjetet”, të Vendimit nr. 120, datë 19.12.2024, të Këshillit Bashkiak Kamëz, për: Sistemin e Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Kamëz”, i ndryshuar, bëhet shtesa si më poshtë:

	Kategoritë	Tarifa Lekë
C.	Parkimi në zonat rezident	
1	Tarifë Parkimi me Kartë Rezidenti (për mjet)	1,000 lekë/vit

4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Transportit dhe Licencimit
5. Ky vendim hyn në fuqi pas **konfirmimit ligjor nga Prefekti i Qarkut Tiranë.**

KRYETAR KËSHILLI
HYSEN KOLDASHI